

# “Ura e shtrenjtë” që kërkon ndihmë

fëmijët e të rriturit në sallë këngëtarja Liljana Picari, që është edhe themeluese dhe presidente e Shoqatës "Integriamo-ci insieme", solli një potpuri këngësh popullore shqiptare, duke komentuar para interpretimit në shqip të këngëve përmbajtjen e tekstit apo fabulën e këngës. Posaçërisht për këtë aktivitet, në emër të shoqatës që prezantonte, Liljana kishte sjellë, përveç kostumeve shumëngjyrëshe popullore e interpretimeve, edhe Flamurin shqiptar, i cili u shpalos para spektatoreve, dhe për fëmijët u komentua historia e tij, historia e një populli që mbijetoi pushtimeve e diktaturave.

Pas shfaqjes, për të gjithë të ftuarit u ofruan nga organizatorët pije e ëmbël-sira. Kjo iniciativë e shoqatës kulturore "YouKali" e mbështetur si nga bashkia e qytetit të Bolonjës dhe nga Lagjia San Vitale flet për një sensibilizim të institucioneve ndaj pranisë së emigrantëve dhe shënon një kontribut në integrimin paqësor mes komuniteteve.

Albana Temali



## Intervista

- Si u "gjendët" një ditë në Shqipëri? Si "u gjeta" në Shqipëri... krejt rastësisht! Oxfam i jepte mundësinë vullnetarëve dhe punonjësve të saj, për të vizituar për dy javë një nga vendet në të cilat ajo ka projektet, për të mundësuar që të shihet konkretisht organizimi i jetës në shumë komunitete. Nuk ishte në dorën tonë zgjedhja e vendit, por vetëm mund të shprehnim disa të dhëna se për ku ishim të gatshëm: dhe fati e deshi që unë të isha "e përshtatshme" për Shqipërinë! E them në konfidencë, e me shumë turp, se për Shqipërinë nuk dija asgjë para se të nisësja, vetëm faktin që ishte afër Italisë dhe që shumë shqiptarë njohin mirë italishten e që vijnë për të jetuar në Itali. Nuk njihja historinë e vendit dhe nuk kisha idenë që ishte kaq i bukur!

- Përse shkua në Veri të Shqipërisë? Oxfam punon si në jug ashtu edhe në veri të vendit, por në dy mënyra të ndryshme: nëse në jug zhvillon punë kryesisht zyrtare, në veri është impenjuar në shumë projekte me komunitetet fshatare: duke vizituar këto projekte, këto fshatra, ishte e domosdoshme të flitej direkt me ata, të cilët nxjerrin përfitimin më të madh nga shoqata.

- Sa i përgjigjet realitetit shqiptar "i prekur me dorë" atij për të cilin kishit lexuar ose dëgjuar?

Aspak! Shqiptarët nuk meritojnë absolutisht reputacionin e keq, që

Realizimi i projektit për ndërtimin e Urës së Shtrenjtë, lindur nga iniciativa e Rachele De Felices kërkon edhe ndihmën tonë.

Ky shkrim i referohet një historie të vërtetë, ose më saktë dy pjesëve që ndërtojnë një historië, që tregon për një urë guri në fshatin Urë e Shtrenjtë, Shqipëri.

Historia e vjetër është për t'u dëgjuar me kureshtje, ndërsa historia e re është e ditëve të sotme dhe kërkon kontributin tonë që të këtë një përfundim të suksesshëm.

... Kur ishte vënë guri i parë në këtë urë nuk dihet, "ditëlindja" e saj tashmë është diku në mjegullën e kohëve të lashta. Ashtu siç nuk dihet me saktësi përse zona merr emrin "Ura e Shtrenjtë". Është tentuar t'i jepen shpjegime, por më bindësi është ai që thotë se kjo urë kishte për banorët e zonës një rëndësi jetike, dhe ishte e çmuar si ari. Vlera e saj është e paçmuar edhe sot për jetën e një vendi të vogël atje në malet e Veriut të Shqipërisë.

Por... një ditë kjo Urë u rrëzua. Për të mbijetuar, banorët e zonës me ato pak kursime të tyre sistemuuan një kalim prej metali, duke zëvendësuar në njëfarë mënyre urën e shkatërruar. Por ky kalim është tepër i rrezikshëm, sidomos për fëmijët që duhet të kalojnë çdo ditë mbi të për të shkuar në shkollë dhe ky kalim bëhet i papraktikueshëm çdo vit në pranverë, kur lumi fryhet për shkak të borërave që shkrihen. Kalimi metalik, që zëvendëson urën "rrëmbelhet" nga ujërat e kjo situatë mund të zgjasë edhe për pesë apo gjashtë javë.... Gjatë kësaj periudhe, një pjesë e popullsisë mbetet në izolim të plotë: fëmijët nuk mund të shkojnë në shkollë, të sëmurët nuk mund të kurohen nga e vetmja infermiere e fshatit, dhe akoma më keq, nuk mund të arrihet e vetmja rrugë që të çon jashtë fshatit, e cila gjendet nga ana tjetër të lumit. Kjo dëshmon se çdo vit për rreth një muaj, askush nga këta banorë nuk mund të ketë ndihmë mjekësore, e askush s'mund të shkojë në treg për të shitur prodhimet e kësaj toke, të cilat përbëjnë burimin e vetëm të fitimit për këta njerëz.

Por një ditë, një histori e re nisi për urën, kur në këtë zonë vuri këmbë një vajze italiane, me emrin Rachele de Felice, e cila sapo kishte nisur studimet e saj për doktoratë në Oxford University në Cambridge, MB. Si vullnetare e projekteve Oxfam i caktohet një udhëtim dy javor në Shqipëri. Udhëtimi e dërgoi deri te Ura e shtrenjtë. Kështu njohu historinë e urës dhe pa me sytë e saj të famshmin kalim metalik, që i shërben banorëve për të krijuar lidhje me botën dhe kuptoi rëndësinë që ka kjo Urë. Rachele vendos të propozojë si projekt të Oxfam, i cili pranohet.

Projekti për një urë të re e të sigurt është përgatitur nga një inxhinier shqiptar, i cili mbikëqyr punimet bashkë me Oxfam MB. Banorët e zonës ofrojnë krahu e lirë të punës për ndërtimin e saj. Por që të ndërtohet plotësisht kjo urë ka nevojë edhe për ndërhyrjen tonë: Në ç'mënyrë? Këtë do e kuptoni nga përgjigjet e Rachele, me të cilën pata fatin të komunikoj këto ditë.

Albana Temali

për vetëvendosje në Kosovë do të sjellë shumë efekte pozitive në mbarë rajonin.

Z. Gianni Oliva, pasi u njoh me përmbajtjen e kërkesës së bashkësisë shqiptare, u angazhua personalisht t'ia përcjellë atë institucioneve vendore dhe atyre qendrore në Itali. Ai nënvizoi rëndësinë e kujtesës së akteve të gjenocidit dhe të dhunës që kanë shoqëruar konfliktet etnike të Ballkanit, aq më tepër tani që jemi në prag të vitit 2008, që është shpallur nga Kombet e Bashkuara vit i të drejtave të njeriut.

Shqiptaret janë një ndër bashkësitë e huaja më të mëdha të Piemontit. Ata numerojnë rreth 50 mijë rezidentë në këtë krahinë të Italisë së Veriut. Torino, kryeqendra e krahinës është gjithashtu një nga qytetet italiane me më shumë banorë shqiptarë. Në kryeqendrën subalpine është gjithashtu mjaft i madh edhe numri i studentëve shqiptarë, mbi njëmijë, të cilët studiojnë në fakultetet e Universitetit dhe të Politeknikut të Torinos.

Në manifestimin e 15 nëntorit morën pjesë gjithashtu edhe shumë arbëreshë, pjesë e bashkësisë së madhe të italianëve me origjinë të vjetër shqiptare që jetojnë në krahinën e Piemontit.

Shoqatat pjesëmarrëse në veprimtari janë: "A.N.C.I.F.R.A." - Asti, "A.S.A." - Alessandria, "Besa" - Fossano, "Horizont" - Novara, "Mergimtari" - Torino, "Nënë Tereza" - Asti, "Shqiptarët jashtë Atdheut" - Torino, "Vatra Arbëreshe" - Chieri, "Vatra" - Torino.

## URA E SHTRENJTË



vijon nga faqja 23

fatkeqësisht, duket se e kanë në Itali. Janë persona shumë mikpritës, tepër të njerëzishëm, që të bëjnë të ndihesh menjëherë si në shtëpinë tënde. Kemi kaluar orë të tëra në biseda mjaft të këndshme. E pastaj ushqimi, është shumë i mirë! Me pak fjalë, mezi pres të rikthem.

**- Si lindi projekti "AlbanBridge"?**

Pas udhëtimit tim, u ktheva me plot entuziazëm e mirënjohje për këtë vend, që më bujti me kaq ngrohtësi dhe doja ta falënderoja me një gjest konkret. U fol për një urë që shërbente për fshatin dhe m'u duk projekti ideal për t'u ndërmarrë. Por nuk e kisha kuptuar se sa punë do të dilnin.

**- Kush është i përfshirë në këtë projekt?**

Oxfam në Mbretërinë e Bashkuar e në Shqipëri merren me realizimin: kanë gjetur arkitektin dhe mbikëqyrin ecjen e punimeve. Unë merrem me mbledhjen e fondeve, me ndihmën e kolegut Christian Guthier, që ka ndërtuar sitin internet.

**- Në çfarë pike është mbledhja e fondeve për realizimin e projektit dhe çfarë pune po bëhet për të sensibilizuar publikum?**

Mbledhja e fondeve ecën ngadalë! Pas rreth një viti kemi arritur të grumbullojmë vetëm 25% të totale, rreth 5 mijë euro kur duhen 20 mijë. Meqë jam e vetme që punoj për mbledhjen e fondeve, puna nuk ecën me ritmet që dëshiroj, meqë kam edhe studimet për të përfunduar! Jemi duke përdorur të gjitha mjetet e komunikimit, nga kalimi i lajmit "gojë më gojë"

te gazetat, te blog-et e të tjera site internet. Mbështetja që po jep komuniteti shqiptar që jeton jashtë Shqipërisë rezulton më të vërtetë i çmuar. Shpesh më ftojnë të flas për udhëtimin tim në Shqipëri, e kudo që shkoj përpiqem të mbledh ofertat.

**- Kujt i drejtohet "thirrja" juaj për fonde?**

Të gjithëve! Shqiptarëve në Diasporë që kanë mundësi, por edhe qytetarëve të kombësive të tjera, të cilët dëshirojnë të mbështesin këtë iniciativë për një vend, që njihet kaq pak. (për informacione të mëtejshme <http://www.albaniabridge.co.uk/bridge.html>)

**- Çfarë raporti keni sot me banorët e zonës Urë e Shtrenjtë?**

Çdo tre muaj, Oxfam në Shqipëri më dërgon një raport se si ecin punimet e ndërtimit, me foto e ndonjë koment nga banorët. Në pranverë shpresoj të kthehem atje, e të kem mundësinë të përqafoj sërish miqtë e mi shqiptarë.

**- Pasi keni njohur qytete e fshatra, por mbi të gjitha, pasi keni njohur shqiptarët, cili është opinioni juaj sot për shqiptarët dhe Shqipërinë?**

Dëshiroj që të njihen më mirë vlerat e shqiptarëve: deri tani kam njohur persona me një forcë të madhe morale, të gatshëm për të bërë sakrificat të mëdha, për të studiuar apo për të arritur objektivat e tyre, të gatshëm për të përveshur mëngët dhe për të përmirësuar situatën e tyre. Gjithë kjo më ka bërë shumë përshtypje.

*Albana Temali*

Për më shumë

<http://www.albaniabridge.co.uk/>

## E DREJTA PËR TË PUSHUAR

**K**ushtetuta italiane, u njeh punonjësve të varur, të drejtën e përfuzueshme për një periudhë vjetore pushimesh të paguara, domethënë për një periudhë shlodhjeje, të lirë nga veprimtaritë e punës, që t'u japë mundësinë e rifitimit të energjive psikofizike të konsumuara gjatë periushës së punës.

Pushimet nuk mund të refuzohen: çdo marrëveshje ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit që parashikon refuzimin e kësaj të drejte është e pavlefshme, përveç rasteve kur paraqiten rrethana të veçanta në ndërmarrje. Periudha e kalimit të pushimeve përcaktohet nga punëdhënësi, duke pasur parasysh nevojat e ndërmarrjes dhe interesat e të punësuarit. Për këtë qëllim, punëdhënësi duhet t'i komunikojë paraprakisht vartësit të tij periudhën e paracaktuar për kalimin e pushimeve.

Normat mbi pushimet kanë pësuar disa ndryshime në vitet e fundit. Dispozitat e reja në fuqi nga 2004 parashikojnë: të drejtën e të punësuarit për të pasur të paktën 4 javë pushime në vit; të drejtën për të kaluar të paktën dy javë pushime brenda vitit (kjo periudhë duhet të jetë e vazhduar nëse e kërkon i punësuarit); të drejtën për të përdorur periudhën që ngelet në 18 muajt në vijim pas mbarimit të vitit; aplikimin e një mase administrative për dhunimin e këtyre detyrimeve, masë që shkon nga 130 euro deri në 780 euro për çdo të punësuar; ndalimin i zëvendësimit me një shumë parash të periudhës së pushimit prej katër javësh të garantuara, përveç rastit kur ndërpriten marrëdhëniet e punës. Kontratat kolektive mund të përcakto-

jnë afate të ndryshme për kohëzgjatjen dhe kalimin e pushimeve; pushimet që kalojnë katër javët mund të gëzohen edhe pas kufirit kohor prej 18 muajve, ose mund të zëvendësohen nga një shumë parash.

Punonjësi fiton ditët e pushimeve në varësi të periudhës së ditëve të punës që kryen. Për të llogaritur këtë periudhë duhet të konsiderohen si ditë pune edhe periudhat e mungesës në punë: për shtatzëni; për sëmundje dhe fatkeqësi; për zhvillim veprimtarish pranë selive të votimit; për reduktim të orarit të punës. Nuk llogariten periudhat e mungesës për arsye familjare; periudhat e mungesës për sëmundje të fëmijëve; periudhat e pritjes që u jepen të punësuarve të përfshirë në detyra shtetërore me konkurs ose në mbulimin e detyrave sindikaliste provinciale dhe kombëtare. Nuk mund të trajtohen si ditë pushimi: periudhat e paralajmërimit; periudhat e lejes së lindjes (lejes së atësisë) ose të mungesës për arsye familjare; periudhat e sëmundjes së shfaqur gjatë pushimeve; periudhat e sëmundjes së fëmijëve që kanë nevojë për shtrim në spital, me kërkesën e prindërve; periudhat e zhvillimit të veprimtarive për plotësimin e detyrave pranë qendrave të votimit. Në rast festash kombëtare dhe gjatë javës që bien gjatë periudhës së pushimeve, i punësuarit ka të drejtë të kërkojë zgjatje të kësaj periudhe, ose trajtim ekonomik përkatës, siç përcaktohet në kontratën kolektive. Pushimet mund të pezullohen në rast sëmundjeje, me mënyrat dhe format e përcaktuara në kontratën kolektive; sidoqoftë vetëm gjendja e sëmundjes që nuk lejon rimarrjen e energjive në periudhën e pushimeve ndërpret vazhdimin e